



POLITIKA E INVESTIMIT
Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL

PËRMBAJTJE

1.HYRJE.....	3
2.QEVERISJA	4
3.MBROJTJA E ASETEVE.....	4
4.OBJEKTIVAT E INVESTIMIT	5
5.SHPËRNDARJA STRATEGJIKE E ASETEVE.....	6
6.INVESTIMET E LEJUARA	8
7.RISHIKIMI I POLITIKËS SË INVESTIMIT	8

1. HYRJE

Ky dokument përbën Politikën e Investimit të Fondit të Pensionit Vullnetar SIGAL (në vijim “Fondi”) i cili administrohet nga Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit “SIGAL Life Uniqa Group Austria” Sh.a. (në vijim “Shoqëria Administruese”).

Themeluar në vitin 2006 dhe licensuar si Shoqëri Administruese në Mars 2011 nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, aktualisht administron rreth 94 subjekte, me numër total anëtarësh 9079 dhe vlerë të aseteve neto rreth 16,700,000 EUR. (Të dhënat në 31.12.2021)

Kjo politikë është përgatitur në përputhje me ligjin nr.10 197, datë 10.12.2009 “**Për Fondet e Pensionit Vullnetar**”, si dhe të rregullores nr.1, të AMF “**Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të lejuar të investimit të Fondit të Pensionit**” të datës 28.01.2010 Ndryshuar me vendimin e Bordit Nr.120, datë 24.08.2016.

Qëllimi kryesor i politikës është sigurimi që në periudhë afatgjatë Fondi do të ketë aftësinë për të realizuar pagesat e përfitimeve të pensionit në vlerë dhe në kohën kur maturohen.

2. QEVERISJA

Organet drejtuese të Shoqërisë Administruese janë Asambleja e Aksionerëve dhe Këshilli i Administrimit me funksion administrues dhe mbikqyrës.

Shoqëria Administruese ka në strukturën organizative, Komitetin e Investimeve me funksion propozimin e Politikave të Investimit në përputhje me dispozitat e përcaktuara në ligjet në fuqi. Komiteti i Investimeve i propozon Këshillit të Administrimit politikën e investimit dhe strategjinë e shpërndarjes së aseteve financiare të Fondit.

3. MBROJTJA E ASETEVE

Fondi i pensionit është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, i përbërë nga kontributet dhe investimi i tyre, pasi janë zbritur të gjitha tarifat. Fondi i pensionit zotërohet bashkërisht nga disa persona, në pronësi të ndarë dhe ku pjesët e pronësisë përfaqësohen nga kuota në fondin e pensionit.

Fondi është miratuar nga AMF me vendim Bordi nr. 51, datë 30.03.2011.

Bazuar në ligjin nr.10 197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, për mbrojtjen e aseteve të anëtarëve:

1. Është absolutisht e pavlefshme çdo përpjekje për të lënë si garanci ose për të përdorur për qëllime të ngjashme asetet në llogarinë e pensionit të anëtarit të fondit të pensionit ose për t'i bërë objekt ekzekutimi apo pjesë të falimentimit të mundshëm.
2. Asetet e fondit të pensionit nuk mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve, të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të shoqërisë administruese të fondit të pensionit.
3. Fondi i pensionit nuk mund të jetë pjesë e procedurës së falimentimit

4. OBJEKTIVAT E INVESTIMIT

Komiteti i Investimit ka përzgjedhur një strategji afatgjatë të investimit të aseteve, me qëllim optimizimin e kthimit nga investimi, duke vepruar brenda nivelit të pranueshëm të rrezikut.

Asetet e Fondit investohen me synim për të optimizuar kthimin nga investimi për anëtarët e tij. Investimi bëhet në përputhje me disa parime:

- ❖ Parimi i Sigurisë – Asetet e Fondit investohen në instrumenta me kredibilitet të lartë
- ❖ Parimi i Diversifikimit të Portofolit – Asetet e Fondit investohen në instrumenta të llojeve dhe karakteristikave të ndryshme
- ❖ Parimi i ruajtjes së nivelit të mjaftueshëm të likuiditetit – duke siguruar që në strukturën e portofolit të Fondit të ketë instrumenta likuide, që mund të blihen dhe shiten shpejt me një çmim të arsyeshëm

Strategjia e investimit ka në thelb besimet se:

- ◆ Investimi afatgjatë gjeneron kthime më të larta
- ◆ Natyra afatgjatë e pagesave të pensionit lejon një horizont afatgjatë të investimit
- ◆ Shpërndarja e aseteve është faktor kryesor në arritjen e kthimeve të investimit në afatgjatë
- ◆ Detyrimet ndikojnë dhe përcaktojnë strukturën e aseteve
- ◆ Investimi i përgjegjshëm përmirëson performancën e kthimit të investimeve
- ◆ Kostot e investimit duhen të minimizohen ku është e mundur

5. SHPËRNDARJA STRATEGJIKE E ASETEVE

Asetet e Fondit investohen me qëllim arritjen e një kthimi të qëndrueshëm optimal me një nivel të caktuar të rrezikut i cili është i pranueshëm, me një fokus në afatgjatë dhe në mbrojtje të kthimit për anëtarët e Fondit. Duke qënë se fokusi i Fondit janë kthimet afatgjata, rezultatet afatshkurtër nuk janë faktor përcaktues për rishikim të politikës dhe strategjisë së investimit.

Shpërndarja strategjike e asetëve për Fondin paraqitet si më poshtë:

Lloji i Aseteve	Shpërndarja strategjike Target
Tituj të Qeverisë Shqiptare	97 % +/-3%
Mjete Monetare dhe ekuivalentë të tyre	3 % +/-3 %

5.1. Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë mjetet monetare të depozituara në Bankën Depozitare dhe investime afatshkurtra në depozita me likuiditet të lartë të cilat kanë maturitet deri në 1 vit që nga momenti i investimit.

5.2. Depozitat me afat

Si përmendur në paragrafin më sipër, depozitat me afat, klasifikohen në zërin mjete monetare dhe ekuivalente të tyre kur kanë maturitet deri 1 vit dhe në kategorinë e aseteve afatgjata si depozita me afat me një maturitet mbi 1 vit. Investimet në kategorinë e dytë nuk janë të shpeshta pasi fokusi i politikës së investimit janë investime afatgjata në tituj qeveritare ku synohet të përfitohet një normë kthimi më e lartë. Asetet në depozita me afat menaxhohen në përputhje të afateve të investimit me kalendarin e emetimeve të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

5.3. Tituj të Qeverisë Shqiptare

Tituj të Qeverisë Shqiptare përbëjnë pjesën më të madhe të portofolit të investimeve për Fondin. Tituj të Qeverisë Shqiptare¹ janë instrumente borxhi të emetuara dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave. Interesi i përfituar në formën e kuponit, paguhet çdo 6 muaj gjatë kohëzgjatjes së instrumentit.

Në rolin e agjentit fiskal të Qeverisë, Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për organizimin e ankandëve, shlyerjen dhe mbajtjen e regjistrit elektronik të titujve shtetërorë të emtuar në tregun e brendshëm.

Investimet në tituj të Qeverisë Shqiptare, Fondi ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim, prandaj janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim (HTM).

¹ Banka e Shqipërisë

6. INVESTIMET E LEJUARA

Asetet e Fondit të pensionit mund të investohen vetëm në instrumentet e përcaktuara sipas Rregullores së AMF miratuar me vendim Bordi nr. 1 datë 28.01.2010, *Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 109, datë 18.10.2010, Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 32, datë 21.03.2012, Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 120, datë 24.08.2016* **“Për Aktivet E Lejuara, Kufizimet Dhe Kufirin Maksimal Të Investimit Të Fondit Të Pensioni”**.

7. RISHIKIMI I POLITIKËS SË INVESTIMIT

Politika e investimit trajtohet si një dokument i cili rishikohet në baza të vazhdueshme. Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe ndryshime të mëdha në detyrimet e Fondit dhe në profilin e kthimit dhe të rrezikut janë kusht për bërë një rishikim të politikës së investimit.

Çdo ndryshim i këtij dokumenti duhet aprovuar nga Këshilli Administrativ në përputhje me ligjin dhe rregulloret në zbatim të tij.